



K.DH.SH.II.nr.293/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhomat e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Faton Bajrami, kryetar i kolegjit, Franciska Zhitia Ymeri dhe Saranda Bogaj Sheremeti, anëtar të kolegjit, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit SH.P.K. “Te Rexha” me seli në Prishtinë të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Shoqëria e Avokatëve “SCLR Partners”, me adresë “Soliteri Avalla” P+12, Prishtinë, kundër të paditurës Dogana e Kosovës (DK) në Prishtinë, me bazë juridike, anulim vendimi, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurës, ushtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Komerciale, Dhoma e Shkallës së parë-Departamenti Fiskal, KF.nr.146/22, të datës 23.12.2022, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 08.05.2023, merr këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pa bazuar ankesa e të paditurës Dogana e Kosovës në Prishtinë, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Komerciale, Dhoma e Shkallës së parë-Departamenti Fiskal, KF.nr.146/22, të datës 23.12.2022, vërtetohet.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës Komerciale, Dhoma e Shkallës së parë-Departamenti Fiskal, KF.nr.146/22, të datës 23.12.2022, nën pikën I të dispozitivit të aktgjykimit është APROVOHET në tersi si e bazuar kërkesëpadia e paditësit SH.P.K. “Te Rexha” me seli në Prishtinë të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Shoqëria e Avokatëve “SCLR Partners”, Prishtinë. ANULOHET PJESËRISHT aktvendimi me nr. 01.3.2.2/14994 i datës 20.12.2019 i Doganës së Kosovës në Prishtinë në pjesën e vendimit ku është konfirmuar aktvendimi me nr.03.1.1-2019-377/1 i datës 15.07.2019 i lëshuar nga ana e Sektorit të Kontrollës Pas Importuese të të paditurës, me të cilin vendim paditësi është ngarkuar me pagesën e taksës doganore 10% më tepër në shumën prej 10,031.19€, të taksës së akcizës në shumë prej 30,200.00€, dhe me Tatim Mbi Vlerën e Shtuar të llogaritur më tepër mbi bazën e kësaj shume në vlerë prej 25,297.77€, në emër të 30 karrocerve-automjeteve të demoluara për pjesë, e të pa zhdoganuara të gjetura tek paditësi me datë 27.08.2019. OBLIGOHET e paditura Dogana e Kosovës në Prishtinë, që paditësit SH.P.K. “Te Rexha” me seli në Prishtinë ta liroj nga pagesa e detyrimeve importueses doganore të llogaritura më tepër në shumën prej 65,528.96€, dhe atë shumën prej 10,031.19€ në emër të taksës doganore 10% të llogaritur më tepër, shumën prej 30,200.00€ në emër të taksës së akcizës, dhe shumën prej 25,297.77€, në emër të Tatimit Mbi Vlerën e Shtuar të llogaritur më tepër mbi bazën e kësaj vlere. Mbetet në fuqi aktvendimi nr. 01.3.2.2/14994 i datës 20.12.2019, i Doganës së Kosovës në Prishtinë në pjesën ku është konfirmuar aktvendimi me nr. nr.03.1.1-2019-377/1 i datës 15.07.2019, i lëshuar nga ana e Sektorit të Kontrollës Pas Importuese të të paditurës, me të cilin vendim paditësi është obliguar që në emër të 30 karrocerve-automjeteve të demoluara për pjesë të pa zhdoganuara të gjetura tek paditësi me datë 27.08.2019, automjete këto të

vlerësuar në vlerë të përgjithshme prej 42,900.00€, të paguaj taksen doganore prej 10% në shumë prej 4,290.00€ dhe TVSH-në e llogaritur mbi bazën e kësaj shumë në vlerë prej 8,494.20€, apo gjithsej detyrime importuese doganore në vlerë prej 12,784.20€. Secila palë i bart shpenzimet e veta procedurale.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë e paditura Dogana e Kosovës, për shkak të: shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale. Me propozim që Dhoma e Shkallës së Dytë ta aprovon ankesën në tërësi si të bazuar në ligj, ndërsa aktgjykimin e ankimuar KF.nr.146/22, të datës 23.12.2022 ta prish si të pa bazuar në ligj, dhe ta refuzon padinë dhe kërkesën e paditësit në tërësi si të pa bazuar në ligj, duke lënë në fuqi vendimin e kontestuar, ose t'ia kthejë gjykatës së shkallës së parë në rishqyrtim dhe rivendosje.

Gjykata Komerciale-Dhoma e Shkallës së Dytë, shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e ankimuar, pretendimet ankimore, përgjigjen në ankesë, dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të nenit 49 të LKA, nenit 81.H të Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat nr.03/L-222, lidhur me nenin 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative (LKA), gjeti se:

- Ankesa është e pa bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se me aktvendimin e kundërshtuar nr.01.3.2.2/14994 i datës 20.12.2019, të Doganës së Kosovës në Prishtinë, është refuzuar si e pa bazuar kërkesa e subjektit në procedure SH.P.K. “Te Rexha” me seli në Prishtinë, për rishqyrtimin e aktvendimit nr. 03.1.1-2019-377/1 të datës 15.10.2019 të lëshuar nga Sektori i Kontrollës Pas Importuese, si e pa bazuar.

Paditësi i pakënaqur me aktvendimin e lartcekur të paditurës Dogana e Kosovës në Prishtinë, ka ushtruar padi për konflikt administrativ me datën 14.01.2020, me pretendim se i njëjti është i pa drejtë dhe i pa ligjshëm.

Gjykata e shkallës së parë, pas shqyrtimit të padisë së paditësit paraqitur kundër aktvendimit nr.01.3.2.2/14994 i datës 20.12.2019, të Doganës së Kosovës në Prishtinë, dhe pas administrimit të provave si në procesverbal të shqyrtimit kryesor, e duke u bazuar edhe në provat dhe dëshmitë e tjera të lëndës, bie aktgjykimin e ankimuar me të cilin kërkesëpadinë e paditësit e aprovon si të bazuar, anulon pjesërisht vendimin e Doganës së Kosovës, duke vendosur sikurse në dispozitiv të aktgjykimit. Me arsyetim se nga arsyetimit të vendimit të kontestuar del se e paditura ka theksuar se Sektori për Kontroll Pas Importuese ka vepruar drejt kur gjatë ushtrimit të kontrollit ndaj subjektit në procedurë ka ndërmarrë masat e nevojshme për rregullimin e situatës dhe kur ka obliguar subjektin në procedurë këtu paditësin që të paguajë detyrimet doganore në shumën e cekur si në dispozitiv të aktvendimit të atakuar, ku pala nuk kishte mundur të dëshmojë se për mallin lëndor ishin kryer obligimet doganore. Sektori i Kontrollës Pas Importuese për të gjitha veturat e cekura në aktvendimin e atakuar përmes sistemit asycuda dhe cognos ka analizuar dhe kontrolluar secilën veturë veç e veç, ku për dy automjete ka rezultuar se janë zhdoganuar me DUD-at R-6527 dhe R-8256, ndërsa për 30 automjete nuk janë gjetur të dhëna të cilat dëshmojnë se janë kryer detyrimet doganore. Sipas Sektorit për Rishqyrtimin e Vendimeve (SRV) Sektori i Kontrollit Pas Importues (SKPI) e ka ngarkuar me të drejtë me detyrime doganore subjektin në procedurë, pasi që i njëjti ka poseduar mallin lëndor pa i kryer

formalitetet doganore, çka ka rënë në kundërshtim me nenin 198 par.1 pika a) të KDAK-së. Gjykata ka gjetur se vet e paditura në vendimin kontestues ka konstatuar se disa automjete në rastin konkret janë më të vjetra se 10 vite dhe si të tilla nuk është i lejuar zhdoganimi i tyre bazuar në nenin 44, par 2, të ligjit 05/L-132 për automjete, dhe nga kjo gjendje faktike, gjykata vlerëson se e paditura pa bazë ligjore e ka ngarkuar paditësin me obligimin doganor të pagesës së taksës së akcizës në shumë prej 30,200.00€ taksë doganore dhe me Tatim Mbi Vlerën e Shtuar të llogaritur përtej shumës së përcaktuar me ekspertizë financiare në emër të 30 karrocereve të automjeteve të demoluara, pa pjesë, e të pa zhdoganuara të gjetura tek paditësi me datë 27.08.2019, automjete këto të vlerësuara me ekspertizë financiare në vlerë të përgjithshme prej 42,900.00€, për arsye se, në rastin konkret sipas vlerësimit të gjykatës e paditura nuk ka arritur të provojë me prova dhe dëshmi konkrete pretendimin se malli karroceri-automjetet e gjetur tek paditësi me datë 27.08.2019, me rastin e kontrollit të zhvilluar, është mall i cili i nënshtrohet taksës së akcizës, siç përcaktohet me dispozitat e nenit 293 par.5, 6 dhe 12 të KDAK-së. E paditura obligimin e pagesës së paditësit me detyrime importuese doganore, respektivisht taksë doganore në shumë prej 14,321.19€, Akcizë 30,200.00€ dhe TVSH në shumë prej 33,791.97€, apo gjithsej detyrime importuese doganore në vlerë prej 78,313.16€, e ka mbështetur në mendimin për përcaktimin e vlerës nr. 04.1.3/704 të datës 04.09.2019 dhe në Mendimet për Klasifikim Tarifor 04.3 nr.72/22.10.2015, 04.3 nr.73/22.10.2015 dhe 04.3 nr.74/22.10.2015, duke pretenduar se edhe malli lëndor i gjetur tek paditësi klasifikohet në numrin tarifor 8703, si mjete motorike, që i nënshtrohen pagesës së taksës doganore, akcizës dhe TVSH-së, mirëpo gjykata vlerëson se një veprim i tillë i të paditurës nuk është i bazuar në dispozita ligjore në fuqi, ngase e paditura në këtë rast ka dështuar që të paraqes ndonjë procesverbal mbi konstatimin e gjendjes faktike ku do të përshkruaj me saktësi lloji i mallit-automjeteve të gjetura tek paditësi, gjendja e tyre, nuk ka bashkangjitur ndonjë fotografi të këtij malli, nuk ka bashkangjitur ndonjë dokument për ndalimin dhe konfiskimin e mallit të gjetur tek paditësi, dhe se nuk ka arritur as të konstatojë se këto mallra si destinim kanë lëshimin në qarkullim të lirë si automjete motorike me kod tarifor 8703, përderisa vet ka konstatuar se disa prej tyre janë më të vjetra se 10 vite dhe se në nenin 44, par 2, të ligjit 05/L-132 për automjete. Tutje, në këtë drejtim gjykata konstaton se e paditura nuk ka mundur që klasifikimin tarifor të mallit lëndor të gjetur tek paditësi, ta bazojë në mendimet për klasifikim tarifor të cilat janë nxjerr për automjete tjera të cilat nuk kanë të bëjnë fare me subjektin në procedurë, këtu paditësin dhe mallin e gjetur tek ai, por kanë të bëjnë me subjekte dhe vetura tjera, dhe kjo vërtetohet edhe nga fakti këto mendime janë nxjerr me datë 22.10.2015 ndërsa kontrolli tek paditësi është ushtruar nga ana e zyrtarëve të paditurës me datë 27.08.2019.

Qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, si të rregullt dhe të bazuar në ligj në tërësi e pranon edhe kjo gjykatë, për arsye se aktgjykimi i ankimuar nuk është përfshirë me shkelje qenësore të dispozitave të Ligjit për Konfliktet Administrative, të cilat shkelje gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative. Gjykata e shkallës së parë duke vlerësuar ligjshmërinë e aktvendimit të kontestuar në kuptim të dispozitave të nenit 81G të Ligjit për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat nr. 03/L-222 dhe nenit 38 të Ligjit për Konfliktet Administrative, në drejtim të thënies në padi, në përgjigje në padi, provave të administruara në seancë gjyqësore si dhe pas shqyrtimit të shkresave të tjera të lëndës, me të drejtë ka konstatuar se kërkesëpadija e paditësit është e bazuar.

Sa i përket pretendimeve ankimore të paditurës për shkelje esenciale të dispozitave të procedurës, këto pretendime ankimore nuk qëndrojnë, meqë gjykata e shkallës së parë ka

shqyrtuar padinë, fillimisht i ka dërguar padinë përfaqësuesit të paditurës në përgjigje në padi, pastaj ka caktuar seancën e shqyrtimit kryesor, ka nxjerrë prova të mjaftueshme, që do të thotë se gjatë vlerësimit gjykata e shkallës së parë nuk ka bërë shkelje esenciale të dispozitave LKA-së, Ligjit Nr.04/L-102 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat, Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës, si dhe të LPK-së.

Ndërsa sa i përket pretendimeve ankimore për vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, se gjykata e shkallës së parë nuk ka administruar prova për të vërtetuar gjendjen faktike por ato vetëm i ka përmendur dhe ka nxjerr një konkluzion të gabuar duke aprovuar padinë e paditësit. Në arsyetim të aktgjykimit nuk ka vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë gjendjen faktike kur ka konstatuar se Dogana e Kosovës ka dështuar që të paraqes prova se malli lëndor i përket kreut tarifor 8703. Këto pretendime ankimore kolegji i kësaj gjykate nuk i aprovoj, ngase të njëjtat janë të pa argumentuara dhe të pa qëndrueshme në vërtetimin e gjendjes tjetër faktike nga ajo e vërtetuar nga gjykata e shkallës së parë. Sepse gjykata për të vërtetuar konstatimet e cekura si në arsyetimin e vendimit kontestues dhe pretendimet e paditësit të paraqitura në padi dhe gjatë shqyrtimit gjyqësor, Gjykata sipas propozimit të të autorizuarit të palës paditëse përmes aktvendimit A.nr.90/20 të datës 01.02.2022, lidhja e vjetër e numrit të lëndës, tani numri i ri i lëndës KF nr. 146/22, ka caktuar ekspertizë financiare në këtë kontekst tregtar administrativ me ekspertin financiar Vehbi Imeri, i cili ka pasur për detyrë të verifikoj se: a janë veturat objekt i këtij kontesti më të vjetra se 10 vite, a do të mund të zhdoganohen veturat si automjete që mund të lëshohen në qarkullim të lirë, të caktohet vlera reale e këtyre karrocereve dhe të krahasohet kjo vlerë e DUD-ve sipas të cilave është importuar malli i njëjtë apo i ngjashëm dhe të krahasohet vlera e mallit kontestues me vlerën e mallit të shitur në ankand nga e paditura, për mall të ngjashëm apo të njëjtë, të krahasohet vlera e mallit të importuar nga subjekti me vlerën e mallit të njëjtë apo të ngjashëm në tregun vendor, të përcaktojë vlerën reale të detyrimit duke u bazuar në gjendjen reale duke llogaritur taksat reale doganore që duhen paguar për mallin kontestues, bazuar në zhdoganimet e mallit të njëjtë nga e paditura. Eksperti financiar tek ekspertiza e datës 30.11.2022, ka dhënë konstatimet lidhur me kërkesat e dala nga aktvendimi A.nr.90/20, ku ka theksuar se këto mallra nuk duhet të trajtohen mallra që i nënshtrohen akcizës, pasi që të njëjtat nuk lejohet të përdoren në Kosovë për vozitje ngase të gjitha këto janë me timon anglez, 30 copë vetura janë pa motor, të gjitha të aksidentuara, shumica prej tyre pa interior të brendshëm me një shkallë të rëndë të dëmtimeve, andaj ky mall lëndor i takon klasifikimit tarifor 8707 me vet faktin se të njëjtat nuk janë në gjendje të ngasjes, por janë të demoluara. Eksperti tutje ka konstatuar se vlera reale e këtyre karrocereve është afërsisht 30% i vlerës së vlerësuar nga Dogana e Kosovës (143,211.90 euro X 30%), = 42,900.00 euro, të cilin vlerësim ekspertit financiar e ka arsyetuar duke u bazuar edhe në vet praktikën e Doganës, pra në rastet kur aplikohet katalogu schwacke. Tutje Gjykata nga shkresat e lëndës vlerëson se e paditura me të drejtë paditësin e ka ngarkuar me pagesën e taksës së doganës prej 10% në shumë prej 4,290.00€ dhe me TVSH-në shumë prej 8,494.20€, e të cilat detyrime ndryshojnë nga vlera e llogaritur nga e paditura në aktvendimin me nr.03.1.1-2019-377 të datës 15.10.2019, sipas ekspertizës financiare të datës 30.11.2022 dhe precizimit të kërkesëpadisë nga i autorizuari i paditësit në seancën e shqyrtimit kryesor, për mallin karrocere-automjete të pa zhdoganuar të gjetura tek paditësit me rastin e realizimit të kontrollit nga e paditura me datë 27.08.2019, në vështrim të dispozitës nga neni 200, par.1, 2 dhe 3 pika c) të KDAK-së, ku shprehimisht parashihet se ku është parashikuar se *“1. Borxhi doganor në import lind me rastin e shmangies së paligjshme nga mbikëqyrja doganore e mallrave, të cilat i nënshtrohen obligimit të pagesës së detyrimeve të importit. 2. Borxhi doganor lind në çastin kur mallrat i shmangen mbikëqyrjes doganore. 3. Debitor do të jetë: çdo person që blen ose i mban mallrat në fjalë dhe në çastin e blerjes ose të mbajtjes së mallrave ishte në dijeni ose objektivisht duhej të ishte në dijeni, se ato mallra janë larguar nga*

mbikëqyrja doganore”, por nuk ka vepruar kështu edhe sa i përket taksës së akcizës dhe diferencës së taksës doganore dhe TVSH-së, për arsye se, ato karroceri-automjete përveç që nuk kanë mundur të dalin në qarkullim të lirë, nuk ka mundur të regjistrohen dhe as të përdoren për transport të personave, për çka është e ngarkueshme edhe taksa e akcizës sipas Ligjit nr.03/L-112 për Tatimin e Normës së Akcizës në Kosovës, i ndryshuar dhe i plotësuar ky me Ligjin me nr.03/L-220, të njëjtat as nuk kanë pasur destinim të tillë, pra nuk ka pasur kërkesë nga pala paditëse për lëshimin e tyre në qarkullimin e lirë në Kosovë respektivisht në komunikacionin rrugor në Kosovë si Automjete motorike, andaj edhe vlerësimi i tyre nga e paditura nuk është dashur të bëhet sikurse të njëjtat kishin me dalë në qarkullim të lirë si automjete motorike por se është dashur të vlerësohen sikurse karroceri – pjesë për auto vetura ashtu siç e ka përcaktuar edhe eksperti financiar.

Nga tërë kjo që u cek më lartë dhe mbi këtë gjendje faktike, kjo gjykatë konsideron se gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë, ngase nuk është cenuar ligji në dëm të paditurës. Prandaj, pretendimet ankimore në ankesë se gjykata e shkallës së parë gabimisht ka aplikuar edhe të drejtën materiale në dëm të paditurës, ky kolegji nuk i aprovoi, sepse vlerësoi se të njëjtat janë të paqëndrueshme dhe të pa bazuara për tu aprovuar ankesa, dhe se janë të pa ndikim në vërtetimin e një gjendje tjetër faktike nga ajo e vërtetuar edhe nga gjykata e shkallës së parë. Sepse, aktgjykimi i ankimuar i gjykatës së shkallës së parë, është i qartë dhe i kuptueshëm si dhe përmban arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare, të cilat i pranon edhe kjo gjykatë, andaj, ankesa e të paditurës u refuzua si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm. Duke marrë parasysh se gjykata e shkallës së parë, në mënyrë të drejtë ka zbatuar dispozitat procedurale dhe materiale, me rastin e aprovimit të kërkesëpadisë së paditëses, e pasi që me pretendimet tjera ankimore të përsëritura, të njëpasnjëshme, një aktgjykim i tillë nuk mund të vihet në pyetje, ankesa e të paditurës u refuzua si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm.

Mbi këtë bazë e në mbështetje të nenit 49 të LKA-së, lidhur me nenin 200 të LPK-së, të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
Dhomat e Shkallës së Dytë
K.DH.SH.II.nr.293/23, me datë 08.05.2023

Kryetar i kolegjit,
Faton Bajrami